



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj. Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

dhe

NNT "LOSHI-DESIGN"-nga Istogu të cilën e përfaqëson, z. Valmir Loshi, nga Istogu, Komuna e Istogut, me Nr. Rexh. Biznesi, 70689324 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

FASADIMI I NDËRTESAVE (BANESAVE KOLEKTIVE NË RRUGËN "RINIA" NË ISTOG)

Nr. I prokurimit	633-18 - 7362 – 5-2-1 / C162
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 073 / 521

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

FASADIMI I NDËRTESAVE (BANESAVE KOLEKTIVE NË RRUGËN "RINIA" NË ISTOG)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për projektin FASADIMI I NDËRTESAVE (BANESAVE KOLEKTIVE NË RRUGËN "RINIA" NË ISTOG) është:
31.111,11 €

dhe me fjalë: /Tridhjetëenjë mijë enjë qind enjëbëdhjetë euro/11/100

2.2. Oferta financiare e kontraktorit e datës: 22.10.2018 është pjesë integrale e kontratës dhe bazë për pagesën e kontratës.

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit

Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:
Loshi Design

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Valmir Loshi
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës I prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data	22.11.2018	Data	22/11/2018
V u l a:		V u l a	

PJESA III E KONTRATES**kushtet e veçanta**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha SHQIPE
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: sipas Ligjeve në fuqi që rregullojnë lemin e siguracioneve.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 1. ditë nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	10	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është: 10% e shumës totale të kontratës, në një afat prej 60 ditësh
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit të punimeve, do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve dhe furnizimeve do të jetë: 20.12.2018
Dëmet likuiduara	19.1	Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e çmimit final të Kontratës.

Inspektimi dhe testimi	22.1	INSPEKTIMI DHE MBIQYRJA E PROJEKTIT DHE Kompanija mbikqyrëse "SIB- BKA" & "LIRIU", nga Gjakova e kontraktuar nga Autoriteti Kontraktues, është mbikqyrëse e kontratës, e cila ka për obligim të përcjellë rrjedhën e punimeve dhe të raportojë AK-në për rrjedhat dhe përbushjen me sukses të kontratës.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në euro ashtu si raporton Organi Mbikqyrës bazuar në raportin e mbikqyrësit, pas kryerjes së punimeve dhe shërbimeve përkatëse.
Përmirësimi i defekteve	31.1	Periudha garantuuese e defekteve është 365 ditë, pas përfundimit të punëve, bazuar në deklaratën e kontraktorit.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.1	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet ARBITRAZH – ODA EKONOMIKE E KOSOVËS